


MNN Qendrore

MISIONET NDËRKOMBËTARE NAZARETASE

3 Shtator 2025

Rajoni i Euroazisë



Armenia

Puna e Kishës së Nazaretasit në Armeni filloi zyrtarisht në vitin 2002. Armenia është një vënd malor pa dalje në det, që kufizohet me Turqinë dhe rrethohet nga malet Biblike të Araratit. E famshme për historinë e saj të lashtë e të pasur dhe luftërat në dukje të pafundme për territoret e saj që vazhdojnë edhe sot, Armenia ishte kombi i parë që adoptoi Krishterimin si fe shtetërore në vitin 301 pas Krishtit. Në vitin 1988, një tërmet shkatërrues la shumicën e popullsisë pa shtëpi ose pasuri, dhe pjesa më e madhe e ekonomisë Armene u shkatërrua pas tërmetit. Mund të argumentohet se Armenia është ende duke u përpjekur të rimëkëmbet nga ajo ngjarje katastrofike. Përveç kësaj, Armenia është përpjekur të përmirësojë ekonominë e saj dhe të rifitojë territoret pas ndarjes së saj nga Bashkimi Sovjetik në vitin 1991. Pavarësisht situatës sfiduese ekonomike, Kisha e Nazaretasit në Armeni ka qenë duke i inkurajuar me sukses njerëzit të japin për të tjerët dhe t'u shërbejnë kishave dhe kombeve të tjera në nevojë. Ekziston një dëshirë e thellë për të rritur udhëheqës të fortë Nazaretas, duke angazhuar fëmijët dhe të rinjtë përmes shërbesave ndërgjeneracionale.



363 Anëtarë



4 Kisha të organizuara
plotësisht



2 Shërbëtorë të Liçensuar
dhe 5 shërbëtorë të
shuguruar në 1 Distrikt

LUTJE



- Lutuni që fëmijët të ndiejnë thirrjen e Frymës së Shenjtë që ti nxisë zemrat e tyre drejt një shërbese për gjithë jetën.
- Lutuni që më shumë kisha të kenë një zemër për të arritur fëmijët e komuniteteve të tyre.
- Lutuni që prindërit e fëmijëve të gjejnë Zotin përmes fëmijëve të tyre dhe shërbësve të Klubit të Fëmijëve.

LAVDËRIM



- Lavdi Zotit për trashëgiminë që Klubi i Fëmijëve të Jerevanit ka për rritjen e udhëheqësve të rinj.
- Lavdi Perëndisë për kreativitetin e vullnetarëve.
- Lavdi Zotit për udhëheqësit e sotëm (ata u rritën në Klubin e Fëmijëve). Kjo është vërtet një korrje e madhe që Perëndia na ka dhënë.
- Lavdi Perëndisë, që përmes një rritjeje dhe zgjimi të tillë, tashmë ekziston nevoja për një vend të ri për të adhuruar dhe shërbyer.



Kaleidoskopi për Fëmijë

Klikoni [këtu](#) për të hyrë në Kaleidoskopin për Fëmijë, një shtesë mujore në MNN-në Qendrore për të zgjuar dhe ushqyer një frymë misionare tek të gjithë.

Një Shikim i Shpejtë MNN



Kisha e Nazaretasit në Jerevan në Armeni, priti Klubin e Fëmijëve të së Shtunës me një temë të veçantë 'Udhëtim në Itali!' ku fëmijët bënë flamuj, pica, ushqime të veçanta dhe madje mësuan disa fjalë dhe fraza Italisht. Drejtuesja e Klubit të Fëmijëve, Rev. Anna Jara, tregon se eventi ishte pjesë e një programi më të madh të planifikuar muaj më parë. "Ekipi ynë kishte idenë të krijonte një udhëtim imagjinar në Itali për fëmijët," tha ajo.



Ekipi vullnetar, kryesisht adoleshentë dhe të rinj që u rritën vetë në Klubin e Fëmijëve, bënë gjithçka për ta bërë këtë ditë të paharrueshme për fëmijët. Ata përgatitën pasaporta, bileta udhëtimi, vula dhe stacione të ndryshme. Në çdo stacion, fëmijët mësuan rreth monumenteve të famshme Italiane, krijuan flamuj Italianë, mësuan disa fjalë Italisht, bënë picat e tyre dhe madje shijuan ushqime Italiane. "Ishte një përvojë e mahnitshme për fëmijët dhe ne planifikojmë të vazhdojmë me këtë ide krijuese në të ardhmen," tha Jara.

Kisha është jashtëzakonisht krenare për përkushtimin e ekipit për të krijuar një ditë të paharrueshme për fëmijët. Përtej aktiviteteve argëtuese, ndikimi i vërtetë i ditës erdhi nëpërmjet dashurisë dhe përkushtimit të treguar nga këta vullnetarë, të cilët treguan vërtet dashurinë e Krishtit.



Kisha në Armeni po lutet për këta vullnetarë të rinj dhe për brezin e ardhshëm që ata po ndihmojnë të formohet. Zoti vazhdoftë të hapë dyert për ata që dëshirojnë të bashkohen në këtë punë, duke dishepullizuar dhe fuqizuar udhëheqës të rinj në mbretërinë e Tij.

Evente të tjera të veçanta të udhëhequra nga të rinjtë dhe Klubi i Fëmijëve ndodhin në Krishtlindje dhe Pashkë, ku ata vizitojnë një shtëpi për të moshuarit, duke ndarë ëmbëlsira që kanë mbledhur si dhurata për banorët e shtëpisë. Ata sponsorizojnë një qendër ushqimore me ëmbëlsira të preferuara, kryejnë prezantime të veçanta gjatë VBS, e cila ndodh në sezonin e Krishtlindjeve, dhe perfomojnë një interpretim të Darkës së Fundit në Pashkë. Të ardhurat nga këto evente të veçanta shkojnë në Fondin e Ungjillizimit Botëror (FUB).

Përshtatur nga një histori e ndarë fillimisht nga Jonathan Daugherty në faqen e Facebook-ut të Rajonit të Eurazisë të Kishës së Nazaretasit.

A mund të shërbeni?

A po ju thërret Zoti të bashkoheni në misionin e Tij në Rajonin e Eurazisë? Për më shumë informacion, klikoni [këtu](#).

MNN Qendrore është e disponueshme në një arkiv në formatin PDF.

Për të lexuar botimet e mëparshme, klikoni [këtu](#).



17001 Prairie Star Pkwy
Lenexa, KS | 66220 US

KISHA e
NAZARENIT